



GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:302808

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05420721

**C.nr.185/2024**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Alush Sinani, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen juridike të paditësit I.S.nga fshati S., Komuna V., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.A., avokate në V., kundër të paditurës Komuna e V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontesitit 836 €, pas pranimit të përgjigjes në padi, jashtë seancës gjyqësore, me datë 05.03.2024, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

**I.** Aprovohet e bazuar kërkesëpadija e paditësit I.S.nga fshati S., Komuna V. dhe detyrohet e paditura Komuna e V. që paditësit, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit t'ia paguajë shumën 836 €, për 418 ditë pune, për periudhën nga data 23.01.2021 deri më 22.11.2022, me kamatë ligjore në lartësi 8%, e e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

**II.** Detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumën 124 €, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

**Arsyetim**

Paditësi, përmes përfaqësueses së tij, me datë 28.12.2023, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, duke theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në ShFMU "Dëshmorët e 5 Prillit" në fshatin S., në V.. Si prova, padisë i ka bashkëngjitur Vërtetimin e punës në shkollën "Dëshmorët e 5 Prillit", nr. 58/2023, të datës 04.10.2023 dhe Kërkesën drejtuar të paditurës të datës 04.12.2023. Të drejtën e tij e ka bazuar në nenin 35 paragrafi 7 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK), të datës 18.04.2017, ku është përcaktuar: "Të punësuarave u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie të punës primare në institucionet arsimore.

Numri i lëndës: 2023:302808  
Datë: 07.03.2024  
Numri i dokumentit: 05420721

Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarave përmes restaurantit a kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim” andaj bazuar në këto, paditësi nga gjykata ka kërkuar që e paditura t’ia paguajë shumën 836 €, për 418 ditë pune, për periudhën nga data 23.01.2021 deri më 22.11.2022. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar edhe atë 104 € për padi dhe shumën 20 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, me përgjigje në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, me pretendimin se nuk është përgjegjëse për detyrimet nga Kontrata Kolektive e V.t 2017 pasi pagat dhe mëditjet paguhen nga ministria përkatëse e poashtu, tutje ka pretenduar se Qeveria dhe Ministria e Arsimit e kanë shfuqizuar Kontratën Kolektive (tutje KK) të SBASHK-ut, nr. 105, të datës 22.01.2021 si dhe KK paraprake nr. 01B/2056, të datës 21.11.2022 prandaj edhe nuk rrjedh kurrfar obligimi për të paditurën ndaj paditëses. Lidhur me shpenzimet procedurale, nuk është deklaruar.

Gjykata ka gjetur se asnjë nga faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese: ekzistimi i marrëdhënies së punës si dhe fakti se paditësi ka qenë i pranishëm në punë 418 ditë, përkatësisht nga data 23.01.2021 deri më 22.11.2022 pasi as e paditura nuk i ka kontestuar këto fakte.

Gjykata ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigjja në padi konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritot atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesë padinë” dhe ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar, kjo sepse gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadia e paditësit.

Sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, është përcaktuar: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, lidhur me nenin 35, par. 7 të KKAK-së, të datës 18.04.2017 dhe KKAK-së të datës 22.01.2021, ku është përcaktuar se: “Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarave, përmes restaurantit a kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”, gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës:

2023:302808

Datë:

07.03.2024

Numri i dokumentit:

05420721

Lidhur me kamatën gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së, i cili ka përcaktuar se: “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton përpos borxhit kryesor edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”.

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara sepse palët kontraktuese të KKAK-së, (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”. Gjithashtu, neni 37 ka përcaktuar se: “Palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe t’i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në nenin 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi e paditura e ka humbur kontestin gjyqësor dhe për këtë arsye u detyrua t’ia paguajë paditësit shpenzimet për taksë në shumën 20 € dhe për përpilimin e padisë shumën prej 104 €.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar edhe në nenin 142 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.**

**C.nr.185/2024, Datë 05.03.2024**

**Gjyqtari,**  
Alush Sinani

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.